

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

### Drejtor, Drejtorja e Kontrollit të Terrenit (Kategoria II-b).

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë:

### Kërkesat e posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor (*ose të barazvlefshme me to*). Diploma e nivelit Bachelor, duhet të jetë e të njëjtës fushë (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

### Drejtori i Kontrollit të Terrenit ka për detyrë si më poshtë:

Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit varet nga Kryeinspektori dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Raporton periodikisht (raporte ditore, javore e mujore) tek Kryeinspektori për masat e marra dhe punën e kryer nga grupet e inspektorëve;
2. Organizon, koordinon dhe drejton punën e drejtorisë, nëpërmjet shpërndarjes së detyrave, kërkesës së llogarisë, marrjes së masave dhe paraqitjes së propozimeve;
3. Bashkërendon punën mes IMT dhe institucioneve të tjera shtetërore për identifikimin dhe zbatimin e masave në funksion të parandalimit të ndërtimeve të paligjshme;
4. Harton planin e masave administrative dhe organizative për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të strukturave të IMT, për evidentimin e ndërtimeve të paligjshme në territorin e Bashkisë Tiranë;
5. Bashkërendon punën me strukturat e tjera të IMT për të mundësuar zbatimin e planeve ditore të punës të grupeve të inspektorëve;
6. Bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit për ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale të depozituara nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit;

7. Organizon shpërndarjen e inspektorëve në grupet e inspektimit sipas Njësive Administrative Zonale;
8. Kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi nga Inspektorët e IMT;
9. Përgjigjet për realizimin e objektivave të vendosura;
10. Verifikon dhe firmos të gjithë aktet në emër të drejtorisë;
11. Përgjigjet për zbatimin e rregullores së Brendshme nga punonjësit në varësi;
12. Harton planet e punës duke vendosur prioritete dhe i miraton tek Kryeinspektori si dhe ndjek zbatimin e tyre;
13. Analizon punën e drejtorisë dhe jep mendime për mënyrën e zgjidhjes së problematikave;
14. Kontrollon dhe verifikon veprimtarinë e punës të të gjitha strukturave të njësive zonale dhe në rast të konstatimeve të shkeljeve i propozon Kryeinspektorit marrjen e masave.

**Dokumentat që aplikanti për Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Terrenit duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Dëshmi e gjëndjes mjekësore;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit;

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me **datë 20.09.2023 ora 16.30**.